



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Media dhe Komunikimi (2022/2023)**

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i tretë (doktoratë)
SETK	180
Kodi	PhD-MC
Titulli	Doktor i shkencave në media dhe komunikim
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-1778/1
Data akreditimit	10.06.2022

Përshkrimi i programit

Programi studimor i ciklit të tretë në Media dhe Komunikim në kuadër të Departamentit të Shkencave të Komunikimit në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit është një nga tri rrugët e dallueshme për median dhe komunikimin, kërkimin dhe praktikën. Duke shfrytëzuar teoritë bashkëkohore të kulturës dhe të menduarit kritik, studimet e doktoraturës në Media dhe Komunikim fokusohen në ndërveprimin e komponentëve kryesorë të komunikimit bashkëkohor: institucioneve të medias, përmbajtjeve dhe rekomandimeve, si dhe audiencës së tyre - veçanërisht si një proces me anë të të cilit vihet në pah rëndësia kulturore. Studimet e doktoraturës së këtij programi e shqyrtojnë procesin nga një këndvështrim ndërdisiplinar përmes interaksioneve sociale, ekonomike, politike, historike, ligjore, rregullatore dhe ndërkombëtare, duke theksuar çështjet që përfshijnë teknologjitë dhe politikat e reja të komunikimit. Të diplomuarit do të angazhohen në një mjedis që përbën pedagogjinë kritike, krahasimin në terma intelektual dhe krijues midis formave bashkëkohore të analizës intelektuale dhe modeleve të tjera po aq të thella të eksplorimit që çojnë drejt përvetësimit të njohurive përmes kërkimit.

Studimet e doktoraturës në Media dhe Komunikim synojnë t'i pajisin studentët me kompetencat dhe mjetet e nevojshme për të zhvilluar projekte kërkimore që përfshijnë standardet më të larta shkencore dhe nivele të avancuara të rëndësisë etike. Përveç zotërimit të prirjeve të ndryshme teorike dhe qasjeve metodologjike, doktorantët do të zgjerojnë edhe kapacitetet e tyre për analizë kritike dhe interpretim të fenomeneve të ndryshme të komunikimit. Kurrikula është hartuar për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës në fusha të caktuara si: në fushën e medias dhe komunikimit, politikëbërjes kombëtare dhe ndërkombëtare, zhvillimit të korporatave në fushën e medias, komunikimit digjital dhe interaktiv, kompanitë e internetit, zhvillimin e portaleve, gazetarinë, komunikimin në biznes dhe organizativ, marrëdhëniet me publikun, etj. Ky program studimi ndjek tendencat bashkëkohore evropiane dhe botërore dhe ka shumë ngjashmëri me programet e tjera ndërkombëtare të studimeve brenda sistemit arsimor evropian. Programi studimor u ofron studentëve njohuritë më të fundit të zbatuara shkencore në fushën e medias dhe të komunikimit, në përputhje me të paktën tre programe studimi të akredituara të institucioneve ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Karriera

Të diplomuarit në këtë program studimor të doktoraturës përgatiten për karrierë akademike në universitete dhe për punësim si analistë mediash në kërkimin e aplikuar, si dhe për role të larta në fushën e politikës dhe të komunikimit në sektorët qeveritarë dhe jofitimprurës.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Përvetësimi i njohurive dhe të kuptuarit të procesit të komunikimit në përgjithësi dhe zotërimi i njohurive të thella të teorive dhe qasjeve kryesore nga media dhe komunikimi.

Marrja e njohurive të avancuara për: median dhe komunikimin, llojet e fushatave të komunikimit dhe strategjitë e marrëdhënieve me median.

Zhvillimi i të menduarit analitik dhe kritik për mediat dhe komunikimin dhe strategjitë dhe taktikat e tyre.

Origjinalitet në aplikimin e ideve autonome për krijimin e një mesazhi të qartë në media dhe komunikim, si dhe të shkruarit dhe të folurit kompetent në media.

Fitimi i përvojës së avancuar praktike në media dhe komunikim.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Të ndërmjetësojnë në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet dy ose më shumë palëve.

Të planifikojnë menaxhimin e projektve (përgatitja e kërkimit shkencor, organizimi i zbatimit të kërkimit, zbulimi në kohë i problemeve të mundshme, përcaktimi i fondeve të nevojshme, menaxhimi i ekipit kërkimor).

T'i aplikojnë paketat statistikore për kryerjen e analizave statistikore të të dhënave (mundësia për të nxjerrë përfundime në bazë të të dhënave cilësore dhe sasiore).

T'i zbatojnë metodat shkencore (metodologjitë shkencore), në punën e pavarur kërkimore.

Të hartojnë dhe zbatojnë paradigma të reja teorike bazuar në arritjet shkencore në fushën e kërkimit.

T'i aplikojnë shkathtësitë akademike të shkrimit dhe raportimit (aftësitë e të folurit dhe të dëgjuarit, aftësitë për të paraqitur të dhëna dhe të gjetura para një publiku joprofesional).

T'i zbatojnë njohuritë e bazuara në tendencat moderne të të menduarit në shkencat e informacionit dhe komunikimit.

Aftësitë për të vlerësuar

Aftësi për të vlerësuar dhe përzgjedhur strategji në media dhe komunikim dhe më konkretisht aftësi për të vlerësuar dhe përzgjedhur kanalet dhe modelet e komunikimit.

E drejta për të zgjedhur format e medias dhe komunikimit, puna dhe vlerësimi i medias së re më të përshtatshme për një mesazh të caktuar komunikues në procesin e komunikimit.

Vendime në përzgjedhjen e argumenteve dhe fakteve për një mesazh efektiv komunikimi në media dhe komunikim.

Identifikim i pikave të forta dhe të dobëta në menaxhimin e disa strategjive të komunikimit në media dhe komunikim.

Aftësi për t'u angazhuar në nivel profesional në media dhe debate publike dhe për të argumentuar pikëpamjet e tyre, të mbështetura me fakte, për tema që lidhen me komunikimin, mediat e reja, formimin e opinionit publik etj.

Mbledhja e informacionit kritik (kërkimi i literaturës, leximi kritik dhe zbulimi i paragjykimeve, aftësitë e intervistimit).

Aftësitë e komunikimit

Të planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë prezantimet e ideve, koncepteve dhe strategjive të reja në fushën e medias dhe komunikimit.

Të hartojnë plane për komunikimin e mesazheve, ideve dhe vendimeve të institucioneve dhe organizatave në praktikën e medias dhe komunikimit.

Të bëjnë prezantime profesionale të qarta dhe koherente mbi një temë ose detyrë që lidhet me median dhe komunikimin, duke përdorur shembuj referues dhe zgjidhje.

Të përdorin burime të avancuara për përmirësimin dhe zbatimin e mëtejshëm të njohurive të marra.

Të shprehen në mënyrë profesionale dhe elokuate në media, si dhe të fitojë aftësi të folurit publik për çështje dhe tema që lidhen me shoqërinë dhe komunikimin masiv.

Të krijojnë strategji komunikimi me publikun dhe të aplikojnë taktika dhe mjete të përshtatshme për realizimin e strategjive dhe planeve të komunikimit.

Aftësitë e të mësuarit

Të kenë aftësi profesionale/eksperte për kërkime në fushën e medias dhe komunikimit, të mbështetur nga teknologjitë e përparuara të informacionit.

Të bëjnë analiza në fushën e medias dhe komunikimit përmes qasjes teorike dhe metodologjike dhe të përdorin literaturën shkencore dhe pasqyimin e autorëve të tjerë.

Të thellojnë njohuritë teorike duke problematizuar situata të ndryshme komunikimi në media dhe komunikim.

Të formulojnë pyetje kërkimore dhe të përgatisin pyetësorë dhe metoda të ndryshme shkencore në kërkimin shkencor në fushën e medias dhe komunikimit.

Të marrin iniciativa dhe përgjegjësi për krijimin e politikave globale të komunikimit në institucione.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [C2347] [10.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [C2215] [10.0 SETK] **Teoria e komunikimit dhe mediat**
- [C2348] [10.0 SETK] **Shkrimi i disertacionit të doktoratës**

Semestri 2

- [DLCC0104] [10.0 SETK] **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [PHD-S3-S4-01] [40.0 SETK] **Punë kërkimore-shkencore**

Semestri 4

- [PHD-S3-S4-02] [15.0 SETK] **Publikime I**
- [C2019] [5.0 SETK] **Mobiliteti i studentëve**

Semestri 5

- [DLCC0105] [20.0 SETK] **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**
- [PHD-S5-01] [10.0 SETK] **Publikime II**

Semestri 6

- [C2299] [30.0 SETK] **Disertacioni i doktoratës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë ka për qëllim të shpjegojë metodologjitë dhe teknikat e punës shkencore, të cilat studentëve u krijojnë shumë vështirësi. Ushtrimet praktike do t'u ndihmojnë studentëve të orientohen në bibliotekë, të shkruajnë një punim shkencor, referate, punime seminarike, etj. Në kuadër të kësaj lënde, do të përfshihen temat si: përcaktimi i temës, bibliografia, rregullat e citimit, kodet shkencore, organizimi i punës etj.

- **Teoria e komunikimit dhe mediat**

Qëllimet e lëndës: Përfitimi i njohurive të specializuara për teorinë e komunikimit dhe mediat.

- **Shkrimi i disertacionit të doktoratës**

Lënda është dizajnuar për t'i aftësuar studentët që të bëjnë hulumtime shkencore, gjegjësisht për të shkruar punimin e doktoratës. Është paraparë që kjo lëndë të jetë praktike dhe t'u japë studentëve njohuritë, mundësinë dhe besimin e duhur për t'iu qasur me sukses hulumtimit të tyre shkencor. Për këtë arsye, lënda më shumë përbën një bashkëpunim se sa një lëndë që në mënyrë strikte bazohet në leksione. Nga studentët pritet që të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime.

- **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**

Pas semestrit të parë, studenti fillon aktivitetet e tij për përpilimin e planit mbi disertacionin e doktoratës. Aktivitetet përfshijnë përcaktimin e literaturës, përcaktimin e kornizës hipotetike, përkufizimin e metodologjisë së punës dhe përcaktimin e planit individual si dhe prezantimin e parë publik.

- **Punë kërkimore-shkencore**

Në vitin e dytë (semestri 3 dhe 4) kandidati vazhdon me veprimtarinë kërkimore shkencore sipas planit individual të miratuar. Mentori siguron vlerësim lidhur me këto aktivitete në formën e një raporti drejtuar Këshillit mësimor shkencor të fakultetit.

- **Publikime I**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-shkencore sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmit dhe relevancës së hulumtimit.

- **Mobiliteti i studentëve**

Qëllimi i mobilitetit të doktorantëve është të prezantojnë, shkëmbejnë dhe diskutojnë punën e tyre kërkimore me kolegë nga vendet e tjera evropiane për të përmirësuar cilësinë e disertacionit të tyre.

- **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**

Në fund të semestrit të 5-të, pas aktiviteteve kërkimore shkencore sipas planit individual, kandidati, rezultatet e përgjithshme të kësaj faze të punimit dhe të hulumtimit do t'i prezantojë publikisht.

- **Publikime II**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore shkencore sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmit dhe relevancës së hulumtimit.

- **Disertacioni i doktoratës**

Vazhdimi i punës së disertacionit të doktoratës. Dorëzohet teza (disertacioni), pranohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, u dorëzohet anëtarëve të komisionit dhe fillon procedura e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **Sistemet krahasuese të mediave**

Lënda synon të shpjegojë paqartësinë e sistemeve mediatike, ku studentët mund të analizojnë dhe të mendojnë në mënyrë kritike për konceptet dhe modelet, perspektivat evropiane dhe globale të medias, për të përcaktuar kontekstin politik të sistemeve mediatike në aspektin e kushtëzimit social të modernizimit, si dhe të hulumtojnë dhe krahasojnë mediat specifike në Evropë dhe botë, sipas pluralizmit mediatik të përmbajtjeve, homogjenizimit të temave, impulsivitetit të interesave të qytetarëve, ndikimit në zhvillimin e vlerave kulturore dhe demokratizimit të bashkësive shoqërore.

- **Komunikimi masiv dhe shoqëria**

Lënda do të fokusohet në marrëdhëniet e proceseve të komunikimit masiv dhe efektet mbi individin dhe shoqërinë; ndikimi i mesazheve mediatike në njohuritë, qëndrimet dhe sjelljen. Shqyrton ndryshimet shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturore në të gjithë botën nga perspektiva e teorisë dhe praktikës së komunikimit masiv. Siguron një kuptim të aspekteve historike dhe ndër-kulturore/ndërkombëtare të një sërë çështjesh nga perspektiva e komunikimit masiv. Theksi është vendosur si në format e reja interesante të politikës, ekonomisë, ashtu edhe në ndërmarrjet krijuese që po sfidojnë me shpejtësi shumë supozime thelbësore në lidhje me komunikimin dhe identitetin njerëzor. Kjo lëndë do të ndihmojë në zhvillimin e një kuptimi të avancuar rreth fushës së mediave që ndryshon me shpejtësi. Lënda balancon njohuritë teorike me aspektet praktike të medias dhe komunikimit masiv. Studentët do të zhvillojnë aftësi të avancuara në analizën kritike të teksteve mediatike, publikut dhe institucioneve. Ata do të përqendrohen në komunikimin midis individëve, grupeve, organizatave, njerëzimit dhe natyrës dhe mediave në zhvillim përmes të cilave zhvillohet komunikimi.

- **Studime të avancuara të mediave të reja**

Kjo lëndë e avancuar eksploron rolin e mediave të reja në formësimin dhe transformimin e shoqërisë. Ajo heton se si publiku mediatik bëhet prodhues, si gazetaria qytetare dhe kultura digjitale ndryshojnë normat dhe praktikën e vendosura, se si mediat sociale dhe prodhimi i bashkëkohësishë ndikojnë në politikë dhe biznes dhe si lidhet teknologjia me fuqinë dhe ndryshimet shoqërore. Kjo lëndë siguron një kuptim të plotë të transformimeve aktuale dhe aftësive analitike për të hetuar mediat e reja në kontekstin e ndryshimeve shoqërore, politike dhe ekonomike. Pyesim se si është formësuar komunikimi online nga përdoruesit, shtetet dhe bizneset, dhe si shoqëria jonë, nga ana tjetër, është duke u ndikuar nga media e re digjitale. Në të vërtetë, ajo që shohim, dëgjojmë, lexojmë dhe përjetojmë është kryesisht produkt i shoqërisë sonë dhe konfigurimit të saj të veçantë politik, ekonomik, material dhe kulturor. Kjo marrëdhënie, gjithashtu, formëson të kuptuarit tonë për veten, shoqërinë tonë dhe botën përreth nesh. Megjithatë, kultura jonë mediatike po kalon nëpër një epokë të thellë transformimesh - pasi teknologjitë e reja, format e reja të argëtimit, vendet e reja të debatit politik dhe modelet e reja të pjesëmarrjes dhe punës shfaqen në internet. Kjo lëndë do të ndalet në atë se si peizazhi social, politiko-ekonomik dhe kulturor po ndryshon në lidhje me median e re dhe teknologjitë e informacionit. Do të zhvillojmë burime kritike për ta kuptuar më mirë historinë e këtyre teknologjive dhe formave të reja komunikuese; ekonomia dhe politika pas tyre; aspektet socio-kulturore nga të cilat kanë dalë; dhe ndryshimet që kanë shkaktuar. Pasi të pajisemi me këto të dhëna, do të rreshtin pyetje më të thella në lidhje me ndikimin e tyre në shoqëri.

- **Shkrimi strategjik dhe marrëdhëniet me mediat**

Studentët do të jenë në gjendje të zbatojnë teknikat dhe stilet e të shkruarit në marrëdhëniet me median, të përgatisin strategji për organizimin e mesazhit të komunikimit për qëllime të veçanta, të aplikojnë teknika në kërkim të grupeve të qëllimit si, intervista dhe pyetësorë, si dhe të aplikojnë shkathhtësi të veçanta në të shprehurit me shkrim në prezantimin mediatik, promovimin, zhvillimin e markës së kompanisë, sikurse edhe për të kontribuar në ndryshimin e normave dhe vlerave shoqërore. Gjithashtu, studentët do të jenë në gjendje të analizojnë, klasifikojnë dhe krahasojnë efektet e shkrimit strategjik dhe të marrëdhënieve me median nga ana e institucioneve, organizatave dhe shoqatave specifike.

- **Gazetaria dhe komunikimi digjital**

Gazetaria është një fushë e rëndësishme, emocionuese dhe dinamike. Na tregon për veten. Platformat përmes së cilave tregojmë historitë tona evoluojnë. Ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe kritike të të menduarit tek studentët në botën reale, në mënyrë që gazetaria e tyre të informojë me një ndjenjë të ekuilibruar drejtësie, saktësie dhe përvoje jetësore. Kjo lëndë kombinon studimet tradicionale të medias me praktikën e reja të shekullit të 21-të. Kjo lëndë përfshin një gamë të gjerë praktikash tradicionale dhe të reja komunikuese dhe krijuese në të gjitha artet, shkencat, biznes dhe industri - duke eksploruar se si formësohet dhe ndryshon me përparimet e veta fusha teknologjike dhe komunikimet digjitale. Kjo qasje ndërdisiplinare ofron një bazë solide për median dhe komunikimin - si një fushë akademike, një peizazh kulturor dhe një rrjet industrish komplekse. Duke eksploruar teorinë kryesore, studentët do të zbulojnë se si media dhe komunikimi ndikojnë te njerëzit dhe shoqëritë në mbarë botën - duke zhvilluar një kuptim kritik rreth krijimit dhe konsumit të medias.

- **Proceset dhe efektet e komunikimit të ndërmjetësuar**

Qëllimet e lëndës: Përfitimi i njohurive të specializuara të ndërmjetësimit në shkencat shoqërore.

- **Studimet e komunikimit: komunikimi dhe kultura**

Në bazë të përcaktimeve teorike dhe analizave praktike të fenomeneve komunikologjiko-kulturore, studentët do të mund të bëjnë një punim hulumtues - një rast studimor rreth aspekteve të caktuara të ndikimit të ndërsjellë të komunikimit dhe kulturës. Qëllimi i programit është zbatimi i komunikimit dhe i formave të të shprehurit përmes mënyrave të të shprehurit të kulturës së individit, grupeve, organizatave dhe publikut masiv. Studentët, do t'i analizojnë dallimet ndërkulturore në komunikimin verbal dhe joverbal dhe kulturën e komunikimit në mjedise specifike profesionale.

- **Të folurit në publik: fjalimi dhe kritika në shoqërinë demokratike**

Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të avancuara hulumtuese për procesin e komunikimit, përgjegjësitë etike të folësit publik në një shoqëri demokratike, si dhe modelet e ndryshme të fjalimeve informuese dhe bindëse - të gjitha këto nga një perspektivë kritike. Në të njëjtën kohë, studentët do të eksplorojnë modelet më të mira për përgatitjen dhe prezantimin e llojeve të ndryshme të fjalimeve, analizën e publikut, hulumtimin e temave të fjalimeve, përgatitjen e fjalimeve, etj. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike përmes autokritikës konstruktive dhe kritikës së fjalimeve të të tjerëve në procesin demokratik të një shoqërie multietnike.